



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1457/1 prot.

Datë 09.06.2025

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E
OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT
NGRIHEN PRETENDIME

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-38274-02-17-2025, me objekt: “Blerje materiale pastrimi” me fond limit 33,798,872.50 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 20.03.2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Malvina Visoka” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “MURATI D” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Besim Kamberi,” P.F. në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Ë.Center” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “ANBIM” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK me NIPT K91413010N dhe adresë: Njesia Bashkiake nr. 2, Rruga Fatmir Haxhiu, Pallati 2, Shkalla 10, Apartamenti 76, Kati I, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë, me adresë: Rruga “5 Maji”, God.17, Tiranë.

Subjekte të Interesuara:

Operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK me NIPT K91624505A dhe adresë: Preze, AHMETAQ, Fshati Ahemtaq, pranë firmes Ital Kon, Tiranë.

Operatori ekonomik “Malvina Visoka” SHPK me NIPT L61608005C dhe adresë: Dajt Tirane Dajt, LINZE, Rruga Muhamet Veliu, Pallati ILIAD, Shkalla 1, kati 1.

Operatori ekonomik “MURATI D” SHPK me NIPT K42003004T dhe adresë: Rruga Kavajes, Ish- Kombinati Ushqimor, Godine 1- kateshe, Tiranë.

Operatori ekonomik “BESIM KAMBER” P.F. me NIPT L42103023G dhe adresë: Rruga e Qelqit , Zona Kadastrale Nr 3866, Nr Pasurie 310/20 – Kashar, Tiranë.

Operatori ekonomik “Ë.CENTER” SHPK me NIPT K63029402A dhe adresë: Lagjia 8 Shkurti,Pallati 2 katesh ,Perball "Gjimnazit Perikli Ikonomi", Fier.

Operatori ekonomik “ANBIM” SHPK me NIPT L81618008J dhe adresë: Autostrada TR-DR Km1 Zona kadastrale 2679 Numri pasurise 40/55 Tiranë.

Në datën 05.06.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/5388 si dhe nr. Protokolli 1457/2025 datë 05.06.2025 i operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-38274-02-17-2025, me objekt: “Blerje materiale pastrimi” me fond limit 33,798,872.50 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 20.03.2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatorët ekonomikë “Euro Mega 2010” SHPK, “Malvina Visoka” SHPK, “Murati D” SHPK, “Besim Kamberi” P.F., “Ë.Center” SHPK dhe “Anbim” SHPK në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit,

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime”*.

- Lidhur me operatorin ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK, ankimuesi pretendon se: *“nuk i ka argumentuar të katër kushtet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93 të ligjit 162/2020, i ndryshuar...”*.
- Lidhur me operatorin ekonomik “Malvina Visoka” SHPK, ankimuesi pretendon se: *“nuk e ka justifikuar ofertën anomalisht të ulët që ka dorëzuar dhe aq më tepër të ketë provuar me dokumentacion plotësimin në mënyrë kumulative të katër kushteve të kërkuara në nenin 93 të ligjit nr. 162/2020, të ndryshuar...”*.
- Lidhur me operatorin ekonomik “MURATI D” SHPK, ankimuesi pretendon se : *“Konkretisht, bazuar në vendimmarrjet e mëparshme të KPP-së, operatori MURATI D ka shfaqur mangësi në lidhje me përmbushjen e kapacitetit teknik, konkretisht për mospërputhje në numrin dhe kualifikimin e personelit të kërkuar për realizimin e kontratës. Kërkojmë verifikimin nëse ky operator ka paraqitur deklarata apo dokumentacion fiktiv lidhur me personelin teknik apo përvojën profesionale”*.
- Lidhur me operatorin ekonomik “Besim Kamberi” P.F., ankimuesi pretendon se nuk përmbushin kërkesat/kriteret si me poshte:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në pronësi ose qira, të paktën 2 (dy) automjet ATP (automjet i transportit të përzier). Për vërtetimin e kësaj kërkesë duhet të paraqesë, Lejen e Qarkullimit, Siguracionin, Kolaudimin, Taksën e qarkullimit, ose në rast se nuk e ka automjetin në pronësi të paraqesë kontratën e qirasë si dhe dokumentacionin shoqërues për qarkullimin e automjetit (Lejen e Qarkullimit, Siguracionin, Taksën e qarkullimit, Kolaudimin,) të vlefshme.

Shënim: Ky kriter (2.3.5) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë

autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

- Lidhur me operatorin ekonomik “Ë.Center” SHPK, ankimuesi pretendon se nuk përmbushin kërkesat/kriteret si me poshte:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor katalogët/fragmente të katalogut ose skedat teknike për produktet objekt prokurimi me Nr. Rendor 1, 2, 9, 21, dhe 22. Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë produktet e përzgjedhura, si dhe cilit katalog apo cilit prodhues i përkasin. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo specifikimi teknik të kërkuar në DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Shënim: Ky kriter (2.3.2) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë furnizimi nga prodhuesi/distributori të autorizuar, për këtë procedurë prokurimi (objekt, nr.REF), ose autorizim prodhuesi/distributori zyrtar për mallrat objekt të prokurimit sipas tabelës në Shtojcën 7 me Nr. Rendor 1, 2, 9, 21, dhe 22. Në rast paraqitje deklaratë furnizimi/autorizim distributori, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një akt marrëveshje midis prodhuesit dhe distributorit e vlefshme midis tyre. Deklarata e furnizimit/autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Shënim: Ky kriter (2.3.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

- Lidhur me operatorin ekonomik “ANBIM” SHPK., ankimuesi pretendon se : “Bazuar në vendimmarrje të mëparshme të KPP-së, operatori ekonomik ANBIM ka shfaqur mangësi në përmbushjen e një sërë kriteresh të DST-së, përfshirë mospërputhje të specifikimeve teknike dhe mungesë të elementëve provues të kapaciteteve ekonomike, teknike dhe profesionale. Kërkojmë verifikimin nëse ANBIM ka dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm në përputhje të plotë me DST-në, përfshirë autorizimet, dokumentet për mjetet dhe skedat teknike.”.

Operatori ekonomik ankimues pretendon gjithashtu se: “ *ka një shkelje procedurale në afatin e shqyrtimit të ofertave nga ana e Autoritetit Kontraktor*”.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 09.06.2025.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri